



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 107 datë 04.12. 2025

**PËR DHËNIE NË PËRDORIM TË FONDIT KULLOSOR ,TË NJË SIPËRFAQE PREJ
0.1843 HA,NË NGASTRËN NR 27 TË EKONOMISË KULLOSORE “DHËMBEL’PËR
VËNIE ANTENE TË TELEFONISË SË LËVIZËSHME,NGA SHOQËRIA
“VODAFONE ALBANIA”SHA.**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Qeverisjen vendore”, Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, ligji 9693”Për fondin kullor”,ndryshuar në Ligj Nr.49/2016,VKM nr.433 dt.08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike”, i ndryshuar në VKM nr.398.dt 13.05.2025, V.K.M nr.559,datë 29.07.2022”Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të Fondit Pyjor Kombëtar,për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore e jodrusore pyjore”,e ndryshuar, Udhëzim nr.1,datë 09.06.2016”Për rregullat,proçedurat e kërimit,shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullor publik”, Kërkesën nr.3127,datë 25.09.2025,të shoqërisë “Vodafone Albania”SHA,Urdhërin nr.478,datë 10.11.2025,të Kryetarit të bashkisë Përmet”Për hartimin e raportit tekniko-ekonomik,për dhënie në përdorim të sipërfaqes kullorore”,Raportin e vlerësimit Tekniko-Ekonomik,hartuar nga grupi i punës ngritur me Urdhër Nr.478 datë 10.11.2025,të Kryetarit të Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,bazuar në relacionin e paraqitur nga Sektori Bujqësi-Turizëm.Këshilli i Bashkisë Përmet,në mbledhjen e datës 04.12.2025,

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies në përdorim të një sipërfaqe prej 0.1843 ha,në Ekonominë Kullorore”Dhëmbel”,ngastra nr.27,e cila pozicionohet në zonën kadastrale numër 3153,me numër pasurie 257,për vendosje antene të telefonisë së lëvizëshme dhe ndërtime të tjera ndihmëse ,nga shoqëria “Vodafone Albania”SHA.
2. Vlera vjetore e dhënies në përdorim me kontratë qiraje,të jetë sipas vlerësimit të raportit tekniko-ekonomik,bazuar V.K.M nr.559,datë 29.07.2022”Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/Përdorim të Fondit Pyjor Kombëtar,për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore e jodrusore pyjore”,e ndryshuar,shtojca nr.1,pika 7,8 dhe 11.



3. Pas pajisjes së Shoqërisë Vodafone Albania Sh.A, me lejen mjedisore përkatëse, do të vijohet me përpilimin e kontratës nga sektorët përkatës, ku do të përcaktohen kushtet , të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe nënshkrimin e saj nga Kryetari i Bashkisë.
4. Afati dhënies në përdorim është 9 vjet nga data e nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike, Sektori Bujqësi-Turizëm, Sektori Pyje-Kullota, Sektori Juridik.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

KRYETAR
Amila DHIMITRI